

STARINE KOSOVA I METOHIJE, Enti krahinor i mbrojtjes së permendoreve kulturore, Prishtinë vëll. I 1961, vëll. II—III 1964.

Enti krahinor i mbrojtjes së permendoreve kulturore, i cili u themelua në vitin 1954 me qëllim që të ushtrojë punën rreth mbrojtjes dhe studimit të trashëgimit kulturor mjaft të pasur dhe të shumëllojshëm të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, më 1961 filloi të nxjerrë organin e vet *Starine Kosova i Metohije* (Antikitete të Kosovës dhe të Metohisë). Kjo revistë vjetore, përveç informimit të regullt mbi rezultatet e punës së këtij institucioni shumë të rëndësishëm, boton edhe kontributet e bashkëpunorëve të brendshëm dhe të jashtëm si dhe lëndë burimore. Nga përmbajtja e dy vëllimeve të botuara gjer më tani, mund të nxirret përfundimi se ky Ent, në bashkëpunim me një varg institucionesh të tjera republikane dhe federative, gjatë veprimtarisë shumë të gjerë ka arritur rrezultate mjaft të mëdha sa i përket mbrojtjes, konservimit dhe restaurimit të permendoreve të kulturës mesjetare serbe — në rend të parë, pastaj të arkitekturës orientale dhe të monumenteve të Luftës nacionalçlirimtare. Ndërkaq trashëgimi kulturor i shqiptarëve ka ngelë jashtë sferës së interesimit.

Vëllimit të parë të revistës *Starine Kosova i Metohije* i prin artikulli i gjatë i Vladimir Moshinit: *Dorëshkrimet e Manastirit të Graçanicës*, në të cilin bëhet fjalë për 38 dorëshkrime dhe 12 libra të ruajtur, që datojnë nga shekulli XIV—XVII dhe kanë kryesisht një përmbajtje liturgjike. Autori i punimit vështron secilin dorëshkrim dhe pas analizës së hollë paleografike, duke dhënë përmbajtjen e tyre, tërheq edhe një paralele me dorëshkrimet që ndodhen gjetiu. Pastaj vijon punimi i Nadezhda Davidoviç *Paraqitja e Shën Mërisë me Krishtin „Ushqyes” në kishën e Shën Mërisë së Levishës së Prizrenit*. Pasi analizohet kjo freskë e shekullit XIII, bahet krahasimi midis kësaj dhe dy skenave të njëjta të pikturës serbe mesjetare — Shën Mëria me Krishtin si fëmijë në kishën e Shën Mërisë së Hodhiqitrisë në Patrikanën e Pejës (1330) dhe Krishti Ushqyes në kishën e Sopoçanit, që është pikturuar në kohën e Car Dushanit. Në fund nxirret përfundimi se në tri paraqitjet që janë vizione profetike shprehet e njëjta ndodhi.

Më punimin me titull *Pesë permendore osmane me kupola në Kosovë dhe Metohi*, Nusref Rexhiq, duke marrë si objekt trajtimi xhaminë e sulltan Mehmetit Fatihut të Prishtinës, xhaminë e Sinan Pashës të Prizrenit, xhaminë e Hadumit të Gjakovës, hamamin e Prizrenit dhe tyrben e Muratit në Kosovë (afër Prishtinës), përpos të dhënave mbi kokën e ndërtimeve, flet edhe për arkitekturën, dekorimet e brendëshme dhe gjendjen e këtyre permendoreve.

Millan Ivanoviç (*Kisha e Çpërfytyrimit në Budisavc*) vështron arkitekturën, pikturat e ruajtura (shek. XVI), mbishkrimet dhe drugdhendjen e një kisha të ndërtuar në shek. XIV dhe në përtrirë më 1568 nga patriku Markarie.

Për ndriçimin e kulturës serbe mesjetare, është mjaft interesant punimi i Predrag Pajkiç *Kishëzat e fshatit në luginën e Drinit të Bardhë*. Autori kufizohet në shqyrtimin e pikturave të kishës së Shën Kollit (Gjurakove) Shën Prenës (Dërsnik), Shën Mërisë (Dollac), Shën Kollit (Kijevë), Shën Kollit (MleĐan), Shën Kuzmanit dhe Damjanit (Pogragjë), Shën Kollit (Siçevë) dhe Shën Kollit (Gorioc) të cilat u ngritën fill pas përtrirjes së Patrikanës së Pejës (1557).

Në artikullin e shkurtër të Dushanka Lukaç *Mbishkrimet turke të tyrbeve të Muratit dhe Bajraktarit* botohet teksti i transkribuar në turqishtet të re i përcjelur me përkthimin në serbishtet të dy mbishkrimeve që gjinden mbi hyrjen në tyrben e Muratit dhe mbi kronin në oborrin e tyrbes, pastaj i mbishkrimeve mbi varrin e Rifat Pashës (1859) dhe atë të Muhamet Pashës, valiut të Kosovës (1903—1904), mbi kronin e shtjerur të tyrbes së Muratit dhe më në fund teksti i shtatë mbishkrimeve të varrezës në tyrben e Bajraktarit.

Është me interes edhe kontributi i Slobodan Nenadoviç *Shtëpia e Prizrenit*. Në fillim të punimit theksohet nevoja e ruajtjes së disa shtëpive me vlerë të madhe kulturore, të cilat po zhduken nga shkakut i urbanizimit të shpejtë, ndërsa më poshtë vështrohet pozita e qytetit. Në vazhdim trajtohen karakteristikat e përgjithshme arkitektonike me një vështrim të posaçëm të bazës së shtëpisë, arkitekturës së brendshme (elementi kryesor i brendshëm: dhoma, dekorimi i tavaneve nëpër kthina, orenditë, etj.) dhe asaj të jashtme.

Artikulli i Ranko Findrit „*Shtëpitë e vjetra në Vuçitërnë*” trajton kompleksin e shtëpive dhe tipin e tyre, pastaj renditjen (ndarjen) e brendshme dhe konstruksionin.

Në rubrikën *Raportë I. Zdravkoviq — V. Jovanoviç (Punimet arkeologjike — konservuese në kalanë e Zveçanit)* kumtojnë rezultatet e punimeve të zhvilluara nga Instituti federativ i mbrojtjes së përmendoreve kulturore gjatë vitit 1957—1959. Slobodan Nenadoviç (*Trapezaria e kryemjeshtër Gjorgje në Deçan*) njohton mbi punët e zhvilluara nga Enti krahinor i mbrojtjes së përmendoreve kulturore më 1959. Në fund botohet edhe raporti i gjerë i Milosav Lukiq (*Demontimi, transportimi dhe rekonstruimi i konakut të Tahir beut në Pejë*) dhe ai i Milan Ivanoviç (*Punimet konservuese të përmendoreve të kulturës të Kosovës dhe të Metohisë më 1959—1960*).

Vëllimi i I—II i kësaj reviste sjell një varg punimesh që trajtojnë problematikën e gjithënduershme nga lëmi e përmendoreve të kulturës mesjetare serbe. Artikulli i Lazar Miroviç: *Ikonat e Manastirit të Deçanit* analizon konisimat e ikonostasit të hershëm të kishës së Krisht Pantokratorit në Deçan, siç janë: Jezu Krishti, Virgjëresha e përvujtur, Shën Jan Paraardhësi, Shën Kolli dhe Arkangjel Mëh'lli. Këto konisma, që datojnë nga viti 1348, janë vepra të zografëve Longin Rasoforit, Gjorgjes dhe Kosmos — autorë të pikturës murale të manastirit të Deçanit.

Gjorgje Sp. Radojiçiq (*Kontrata e minatorëve tanë të vjetër*) jep disa të dhëna për një kontratë të shkruar në Ungjillin të të katërve nga gjysma e parë e shekullit XVI, dorëshkrim ky që u zbulua afër lokalitetit Graçanicë dhe tani ruhet në manastirin e Pejës.

Vojislav Gjuriç (*Përmendoret e panjohura të pikturës mesjetare serbe në Metohi*) përpunon gjersisht pikturën murale të kishës së Virgjëreshës Hodhigjistri (fshati Mushutishtë) dhe tempullit të Shën Gjergjit (fshati Reçan) që datojnë nga viti 1315 dhe 1370. Autori vjen në përfundim se piktura murale e tempullit të Shën Gjergjit, e cila daton nga viti 1360—1370, për nga fryma e përngjanë asaj të përmendoreve të vllastelës serbe dhe të kishave të vogla të Ohrit dhe paralajmëron çfaqjen e stilit të shkollës së Moravës.

Vojislav Koraç (*Kisha e Shën Varvarës (Shën Mitrit) në fshatin Kmetovc afër Gilanit*) bën fjalë për gërmadhat e një kisha të vogël mesjetare, për të cilën nuk ekzistojnë burime të shkruara. Duke bërë rekonstruksionin e objektit, autori konstaton se fragmentet e freskave të rujuara janë të gjysmës së dytë të shekullit XIV, ndërsa vetë kisha është ndërtuar aty nga fillimi i gjysmës së dytë apo në gjysmën e dytë po të këtij shekulli.

Dejan Medakoviç (*Miniatura të paraklisit të Deçanit*) vështron një paraklis të ilustruar, i cili u shkrua në Vršac më 1762 sipas urdhërit të arkiemandritit të atëhershëm të Deçanit. Pasi analizon katër ilustrimet e këtij dorëshkrimi, të cilat paraqesin Stefan Deçanin, Car Uroshin, Shën Arsenien dhe Shën Savën, Medakoviç vë në dukje ndikimin e artit të barokut.

Nadezhda Davidoviç — Radovanoviç (*Afreska e vizionit të profetit Daniel në kishën e Shën apostujve të Patrikanës së Pejës*), trajton ilustrimet e skenave të Dhiatës së vjetër si dhe të skenave në vizionin e Mbretërisë qëllorë.

Janko Radovanoviç (*Paraqitja e Shën Mërisë në kishën e Shën Mërisë dhe Levishës së Prizrenit*), duke përshkrur mënyrën e paraqitjes së Shën Mërisë përmes pikturave në vendet e ndryshme, supozon se afreskat e kë-

saj kishë janë një kopje e konismave të dikurshme të kësaj kishë, e cila është ngritur në shekullin X—XI.

Për studimin e artit sërb të shekullit XIV është interesant kontributi i Milan Ivanoviq: *Kisha e Virgjëreshës Hodhigjtri në Patrikanën e Pejës*. Këtu bëhet fjalë për skenat e vizatuara, që i përktasin të ashtuquejturit „stil monak — eklesiastik” dhe paraqesin figurat e arkierëve, luftarëve shenjtorë, eremitëve, pastaj ciklet nga jeta dhe vuajtjet e Krishtit, skenat e jetës së Virgjëreshës etj. Sipas autorit në këto piktura bien në sy huazimet ikonografike të Lindjes ortodokse, apo uniteti në një tërësi i temës së përhershme dhe të veçantë ikonografike të Lindjes dhe të Perëndimit.

Pastaj vjen artikulli i Predrag Pakiq me titull: *Kishat e Hoçës së Madhe*. Në pjesën e parë flitet mbi trajtimin e këtij problemi në literaturën e historisë së artit, pastaj për të kaluarën historike të lokalitetit në fjalë dhe për riparimin e këtyre kishave pas përthirjes së Patrikanës së Pejës. Ndërkaq, pjesa e dytë e punimit trajton pikturën e pesë kishave të ruajtura — të Shën Kollit, Shën Janit, Shën Stefanit, Shën Dieles dhe Shën Anës.

Mehmed Mujezinoviq (*Kolekcioni i dorëshkrimeve orientale të bibliotekës së xhamisë së Mehmet Pashës në Prizren*) bën analizën e përgjithshme paleografike të 14 dorëshkrimeve të zgjedhura, të cilat janë nga lëmi e koranit, leksikografisë, medicinës, sintaksës, të drejtës së shariatit dhe filozofisë — didaktikës. Në këtë koleksion bën pjesë edhe korani i vitit 1312, dorëshkrim ky më i vjetër i kësaj biblioteke dhe njëkohësisht kopja më e vjetër e Kornit ndër koleksionet orientale të Jugosllavisë.

Vjen me radhë kontributi i shkurtër i Mirjana Shakotës: *Akatist martirit të parë Stefanit nga zografi Longin* ku pos të dhënave për këtë antikitet letrar, botohet i tërë teksti i akatistit. Në fund të kësaj rubrike botohet artikulli i Milan Ivanoviq *Një monument i Luftës nacional-çlirimtare në Pejë*.

Pjesa e dytë e revistës *Starine Kosova i Metohije* boton raportet e Ivan Zdravkoviq (Adaptimi i hamamit të Prizrenit për Muze dhe galeri pikturash), pastaj të Petar Ballabanoviq (Konservimi i konismave të kishës së Shën Kollit në fshatin Drajçevc të Zhupës së Sredskës) M. Llukiqit (Punimet arkitektonike konservuese në kishën e Shën Kollit në Siçevë) dhe M. Ivanoviqit (Punimet konservuese në monumentet kulturore të Kosovës dhe të Metohisë më 1961).

Të gjitha punimet në këtë revistë botohen vetëm në gjuhën serbokroatishte me rezyme shumë të shkurtëra në shqipet dhe frengjishte.

ZEKERIA CANA

vojë dhe kërkesë e ngutshme, prandaj sot shumica e arkivave po orientohen në publikimin e fondeve relevante. Ndërkaq, karakteristikë edhe e kësaj reviste është se të thuash të gjitha punimet — madje edhe ato të autorëve shqiptarë, janë në serbokroatishte me rezyme të shkurtëra në gjuhën frengjishte dhe shqipe.